

AKT-THEMELIMI
I
SHOQERISE TREGTARE “MPED-XH GROUP” SH.P.K.

Ne baze te ligjit nr 9901 date 14.04.2008 "Per tregtaret dhe Shoqerite Tregtare" dhe ne zbatim me ligjin nr.9723 date 03.05.2007 "Per Qendren Kombetare te Regjistrimit",ligjit nr 129/2014 "Per disa shtesa dhe ndryshime ne ligjin 9901 date 14/04/2008 "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare " te ndryshuar , sot **ne daten 15/06/2021** behet themelimi i shoqerise **“MPED-XH GROUP” SH.P.K** me seli ne **Elbasan, Lagjja Aqif Pasha, zk.8524, pallati nr.29/1, kati 2, ap N13.** nga ortaket e kesaj Shoqerie **Z.Olta Sharra e pajisur me nr personal H86227055N,** banues ne Elbasan, dhe **Elgert Laskaj i pajisur me nr perosnal I71221020E,** banues ne Elbasan.

VENDOSIN

Te krijone nje Shoqeri Tregtare te emertuar **“MPED-XH GROUP” SH.P.K** me kushtet e meposhtme:

NENI 1

Themeluesit ne cilesine e ortakeve krijone shoqerine tregtare **“MPED-XH GROUP” SH.P.K** me statusin juridik te nje shoqerie me pergjegjesi te kufizuar ne kuptimin e ligjit nr.9901 date 14.04.2008 “Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare”,ligjit 129/2014, me mjetet e veta financiare duke paguar kontributin ne para.

NENI 2

Shoqeria gezon statusin e personit juridik dhe veprimtaria e saj do te rregullohet nga legjislacioni shqiptar ne fuqi, nga ky Akt-Themelimi dhe statutin e bashkelidhur.

NENI 3

Shoqeria do te ushtroje veprimtarine e saj me emertimin **“MPED-XH GROUP” SH.P.K** emer ky qe do te shenohet ne te gjitha dokumentat, letrat, faturat etj.
Ajo ka vulen e saj ne te cilen eshte shkruar **“MPED-XH GROUP”, SH.P.K**



NENI 4

Shoqeria e ka seline e saj ne:

Elbasan, Lagjja Aqif Pasha, zk.8524, pallati nr.29/1, kati 2, ap.N13

Ajo mund te hape perfaqesi, dege ose filiale edhe ne qytete te tjera te Shqiperise.

NENI 5

Afati i veprimtarise se Shoqerise do te jete i pakufizuar, me perjashtim te rastit kur ortakët vendosin prishjen e saj.

NENI 6

Shoqeria do te ushtroje aktivitetin e saj me objekt :

Aktivitet ne fushen e ndertimeve. Punime te specializuara ne fushen e ndertimit. Ndermarje ndertimi per vete dhe per te trete ne kryerjen e veprimtarive ndertimore, ndertime civile, industriale, bujqesore, turistike dhe kompletimi me instalimet elektrike, hidraulike, ... etj qe lidhen me to. Studim, projektim, ndertim e zbatim te veprave ndertimore te te gjitha llojeve sipas legjislacionit shqiptar. Projektim, ndertim, montim, zbatim e rikonstruksion te: godinave te te gjitha llojeve, rruge te cdo kategorie, punime nentokesore, ura e vepra arti, ujesjellesa, gazsjellesa, vajsjellesa, vepra kullimi e vaditje, ndertime hidroteknike, mbrojtje lumore, sistemime hidraulike e binifikime, barriera dhe mbrojtje lumore, diga, damba, tunele. Ndertim impjante idrosanitare, kuzhina, lavanteri e mirembajtjen e tyre. Impjante ngritese transportuese. Ndertime parafabrikat beton arme, muratur, struktura metalike e druri. Impjante teknologjike, termike e kondicinimi. Impjante e linja telefonie dhe telekomunikacioni. Impjante te brendsheme lektrike, telefonike, radiotelefoni..etj. Impjante te sinjalistikes rrugore te trafikut, sinjalistika rrugore jo ndricuese. Investime ne ndertime civile, pallate e ne ndertime turistike. Ndertimet dhe projektme inovative te cilat synojne te sigurojne kosto te ulet dhe cilesi te larte, ndertime ekologjike dhe eficente lidhur me ngrohjen dhe ftohjen e brendshme te ndertesave, qofshin ato per nevoja private apo publike. Ndertime duke perdorur material te reja te cilat jane profilet e metalit dhe llamarinat sanduic , profilet dhe matrialet e alumini dhe celiku te perpunuuar ,ne modele dhe ngjyra te ndryshme, duke integruar gjetjet e tyre shkencore kryesisht ne sektorin e ndertimit te banesave, publike dhe private. Tregtimi I pasurive te paluajtshme dhe te

luajtshme. Projektim e konsulence teknike. Joint-veture. Germime. Transport per nevojat e aktivitetit. Transport rrugor kombetar e nderkombetar per vete, te trete e me qira. Tregti me shumice e pakice materiale ndertimi, hidraulike, elektrike,

industriale,..etj. Import-eksport. Dhe cdo aktiviteti tjetër te nevojshem lidhur me objektin e veprimtarise ne perputhje me legjislacionit Shqiptar.

NENI 7

Me vendimin e themeluesve te saj, shoqeria mund te ndryshoje emrin, seline, formen juridike dhe objektin e veprimtarise, mbas berjes se ndryshimeve perkatese ne statut dhe ne kete akt themelimi.

NENI 8

Kapitali themeltar i shoqerise perfaqeson kontributet ne para dhe eshte **100.000** leke shqiptare.

Ortakët:

Znj.Olta Sharra zoteron nje kuote me vlere 50.000 leke ose 50 % te kapitalit themeltar.

Z.Elbert Laskaj, zoteron nje kuote me vlere 50.000 leke ose 50 % te kapitalit themeltar.

NENI 9

Shoqeria kryen veprimtarine e saj per te realizuar fitime. Ajo eshte pergjegjese per detyrimet qe ka ndaj shtetit dhe personave te tjere.

NENI 10

Shoqeria zhvillon veprimtarine e saj administruese, ekonomike, financiare ne perputhje me legjislacionin perkates ne fuqi dhe dispozitat e statutit bashkelidhur. Shoqeria do te drejtohet nga organet drejtuese qe perbehen nga asambleja e ortakëve dhe administratori. Themeluesit me vendim te veçante do te emerojne dhe nje ekspert kontabel. Shoqeria do te mbaje llogarite ne perputhje me ligjin, " Per Kontabilitetin dhe Pasqyrat financiare", si dhe do te krijojë fonde rezerve.

Fitimi neto qe do te rezultojë ne fund te cdo viti financiar pas zbritjes se fondit rezerve dhe humbjeve te mbajtura nga vitet e meparshme do ti kalojë ortakëve.

NENI 11



Percaktimi i struktures organizative te shoqerise, numri i punonjesve dhe emerimet e shkarkimet ne organet e saj behen me vendim te asamblese se ortakeve.

Administrator i Shoqerise emerohet **Z.Laidon Laskaj** e banues ne Elbasan, i pajisur me karte identiteti me numer personal **I40516026I**

Maredheniet e punes do te bazohen ne kontratat e punes te lidhura mbi bazen e legjislacionit ne fuqi.


NENI 12

Rregullat per drejtimin, organizimin dhe prishjen e shoqerise jane percaktuar ne statutin qe i bashkelidhet ketij Akt-Themelimi.

THEMELUESIT E SHOQERISE TREGTARE

“MPED-XH GROUP” SH.P.K.

Znj.Olta Sharra



Z.Elgert Laskaj

